



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 266/2024

Datë: 19 mars 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 19 mars 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Z. Fatos Ajvazi, prokuror në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, avancohet në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Ferizaj nga data 1 prill 2024.
- II. Obligohet z. Fatos Ajvazi që të koordinohet me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për përfundimin e lëndëve të cilat i ka në punë.
- III. Z. Fatos Ajvazi ka të drejtë në beneficionet që dalin nga ushtrimi i detyrës së prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore.
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e mbajtur më datë 19 mars 2024 ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit KPK/KATPSH të datës 16 shkurt 2024, ku pas shqyrtimit të të njëjtit raport, Këshilli me shumicë të votave dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Fatos Ajvazi;
- Kryeprokurorit të PTH Ferizaj;
- Sekretariatit dhe Dosjes së prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.